



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë 21.03.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 19.03.2025, të parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik BONN PROJEKT SH.P.K.; ARCHING GROUP SH.P.K Rruga MUJE KRASNIQI, Ulpian, Prishtina lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Llot 3 Rikonstruimi i ndriçimit publik në Janjevë dhe Gadime e Ulët”, me Nr. të Prok: 613-24-10149-5-2-1 nxjerr këtë:

V E N D I M

I Refuzohet, kërkesa për ri-shqyrtim e Grup i Operatorëve Ekonomik BONN PROJEKT SH.P.K.; ARCHING GROUP SH.P.K Rruga MUJE KRASNIQI, Ulpian, Prishtina dt. 19.03.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Llot 3 Rikonstruimi i ndriçimit publik në Janjevë dhe Gadime e Ulët”, me nr. të Prok: 613-24-10149-5-2-1

Vërtetohet Vendimi i AK për shpërblim me kontratë për TONI INGJINJERING Llapushnik, Magjistralja, M9, Llapushnik.

Mbetet në fuqi Vendimi i AK për shpërblim me kontratë i publikuar me datë: 12.03.2025

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Grup i Operatorëve Ekonomik BONN PROJEKT SH.P.K.; ARCHING GROUP SH.P.K Rruga MUJE KRASNIQI, Ulpian, Prishtina, me datë 19.03.2025 ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit “Llot 3 Rikonstruimi i ndriçimit publik në Janjevë dhe Gadime e Ulët”, me nr. të Prok: 613-24-10149-5-2-1 ku këtë aktivitet AK ka shpallur fitues TONI INGJINJERING Llapushnik, Magjistralja, M9, Llapushnik, **për shpërblim me kontratë** të datës 12.03.2025 dhe ka publikuar në platformën elektronike e-prokurimi.

Grup i Operatorëve Ekonomik BONN PROJEKT SH.P.K.; ARCHING GROUP SH.P.K Rruga MUJE KRASNIQI, Ulpian, Prishtina, me datë 19.03.2025 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit “Llot 3 Rikonstruimi i

ndriçimit publik në Janjevë dhe Gadime e Ulët”, Autoriteti Kontraktues me datë 21.03.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Sa i përket pretendimit për eliminimin tuaj në lidhje me certifikaten e inxhinierit për siguri dhe shëndet në punë, AK nuk ka kërkuar sqarime shtesë për arsye se nëse një dokument i caktuar është i destinuar për një projekt tjetër, e jo për projektin në fjalë për të cilin edhe keni ofertuar, atëherë një dokument i tillë është i papranueshem për AK-në dhe një ofertë e tillë eliminohet si e papërgjegjshme, nëse OE nuk do të kishte ngarkuar këtë certifikatë AK ka qenë i obliguar të kërkojë sqarime shtesë. Ndërsa sa i përket asaj që ju si ofertues keni pasur komunikim zyrtar me ane të e-mailit me këtë inxhinier edhe po të ishte relevante për AK-në, komunikimi i juaj me inxhinierin/at tregon dhe ju kujtojmë se në bazë të dokumenteve të cilat i keni prezentuar në ofertën tuaj, bëhet fjalë për inxhinierin Baki Shala, ndërsa ju në këtë komunikim e keni prezentuar inxhinierin Bashkim Shala. Pra nga ajo që ju keni prezentuar në këtë kërkesë për rishqyrtim kemi mospërputhje të emrit të inxhinierit, përkatësisht kemi të bëjmë me dy persona të ndryshem.

Shtojcë: Komunikimi i e-mailin tuaj me inxhinierin.


AK, konsideron se tenderi juaj është vlersuar me kujdes dhe ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP.

Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.

Bekim Shabani



Drejtor i Prokurimit

